



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr.2630, datë 29.10.2015

Për

Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe ndërmjet ofruesve të shërbimit postar”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1.	Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2.	Z. Alban	Karapici	Anëtar
3.	Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4.	Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5.	Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.M.Drushku, në mbledhjen e datës 29.10.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Për miratimin e dokumentit për këshillim publik “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe ndërmjet ofruesve të shërbimit postar”.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr 8485 datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative” i ndryshuar;

2. Ligji nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, Neni 9 pika 13 dhe 14, Neni 37, 55 dhe neni 56;
3. Ligjin Nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative” i ndryshuar;
4. Urdhër nr. Nr.1525 datë 7.09.2015 Nr.prot.1633 datë 7.09.2015
5. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

1.Relacioni shpjegues mbi dokumentin për këshillim publik “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe ndërmjet ofruesve të shërbimit postar”.

2.Dokumentin për këshillim publik “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe ndërmjet ofruesve të shërbimit postar”.

3.Projektvendimi përkatës, si dhe diskutimet në mbledhje mbi çështjen;

Duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N s e :

1. Dokumentin për këshillim publik “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe ndërmjet ofruesve të shërbimit postar” është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.

2. Hartimi i dokumentit është bazuar në Nenin 9 pika 13 dhe 14, Neni 37, 55 dhe 56 të Ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” ;

3. Qëllimi i hartimit të dokumentit “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe ndërmjet ofruesve të shërbimit postar”, është përcaktimi i procedurave, afateve dhe rregullave dhe strukturës përkatëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe mosmarrëveshjet ndërmjet ofruesve të shërbimit postar duke pasur në vëmendje përmbushjen e objektivave rregullatorë për nxitjen e konkurrencës dhe mbrojtjen e interesave të përdoruesve.

4. Nëpërmjet hartimit të aktit administrativ normativ “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar” si dhe

mosmarrëveshjeve ndërmjet ofruesve të shërbimit postar, synohet të realizohet zgjidhja e mosmarrëveshjeve nga AKEP në mënyrë transparente, të shpejtë, objektive dhe jodiskriminuese.

5. Dokumenti për Këshillim Publik “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe mosmarrëveshjet ndërmjet ofruesve të shërbimit postar” normon në mënyrë të qartë procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, kur të tilla mosmarrëveshje kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Ligjin Nr. 46/2015 dhe aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, duke paraqitur të gjitha fazat dhe etapat e zhvillimit të saj.

6. Draft-Rregullorja është strukturuar në Krerë të veçantë me qëllim thjeshtëzimin dhe lehtësinë në zbatimin e saj nga palët:

- Në rastin e mosmarrëveshjes ndërmjet përdoruesit të shërbimit postar dhe ofruesit të shërbimit postar e cila nuk mund të zgjidhet nëpërmjet procedurave të ankesave, sipas nenit 37, të Ligjit nr.46/2015, përdoruesi, brenda 15 ditëve nga marrja e përgjigjes me shkrim të ofruesit, mund të kërkojë me shkrim nga AKEP-i , nëpërmjet KZM të zgjidhë mosmarrëveshjen.
- Në rastin e mosmarrëveshjes ndërmjet ofruesve të shërbimit postar KZM fillon një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me marrjen e kërkesës së secilës palë në mosmarrëveshje.

KZM shqyrton të gjitha provat në dispozicion dhe, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, merr vendim lidhur me mosmarrëveshjen.

Vendimi i AKEP është i detyrueshëm për palët, nëse nuk kundërshtohet brenda 30 ditëve nga dita e marrjes dijeni në Gjykatën kompetente sipas legjislacionit në fuqi. Për Vendimin e AKEP-it palët kanë të drejtë të ankohen në gjykatën kompetente.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në sa më sipër, në kompetencat që i janë dhënë nga Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative” i ndryshuar, Ligji nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligji Nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative” i ndryshuar;

VENDOS:

1. Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe ndërmjet ofruesve të shërbimit postar”, sipas dokumentit bashkëlidhur.

2. Periudha e Këshillimit Publik do të jetë 30 ditë nga dita e publikimit zyrtar të këtij dokumenti në faqen e internetit të AKEP www.akep.al
3. Ky Vendim dhe dokumenti për këshillim publik “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe ndërmjet ofruesve të shërbimit postar” të publikohet në faqen elektronike të AKEP www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

KRYETAR

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____